

-  
=



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1192/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Qazim Mehmetit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Gjakovë, paraqitur kundër Komisionit të Vendvotimit (KVV), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.1192, Anr.1193, 1194, 1195, 1196 të datës 03.12.2013, të Qazim Mehmetit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Gjakovë .

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1192, Anr.1193, Anr.1194, Anr.1195, Anr.1196 të datës 03.12.2013, të Qazim Mehmetit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1192/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV0208C brenda partisë është bërë tjetërsimi i votave sepse disa votues që më kanë mbështetur votat e tyre më mungojnë. Prandaj kërkoi rinumërimin e votave pasi që vetëm 3 vota më figurojnë. Më tutje ka theksuar në lidhje me procedurën e numërimit të votave në disa VV janë bërë shkelje esenciale dhe dyshoj në një pjesë të anëtarëve të këshillave të VV ku kanë vepruar në kundërshtim me procesin zgjedhor.
- Në ankesën Anr.1193/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 0207C është bërë shkelje e procedurës së votave pasi që janë tjetërsuar votat brenda partisë, ngase unë kamë 18 vota dhe kërkoi rinumërimin e votave.
- Në ankesën Anr.1194 të datës 03.12.2013, pretendohet se, në QV0215C kërkoi rinumërimin e votave, pasi që më mungojnë votat prandaj kërkoi që ankesa ime të shqyrtohet.

- Në ankesën Anr.1195/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 0229C kërkoi rinumërimin e votave, pasi që mu janë konfirmuar 18 vota, ndërsa në raport figurojnë 10 vota.
- Në ankesën Anr.1196/13 të datës 03.12.2013 pretendohet se në QV 0219C kërkoi rinumërimin e votave, pasi që komisionarët i kanë numëruar votat gabimisht.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e Qazim Mehmetit – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë. paraqitur kundër Komisionit të Vendvotimit (KVV) , ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV,të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 1192/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

